



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 8014

Data: 22.09.2023

**PROCESVERBAL I DEBATIT PUBLIK MBI DRAFT RREGULLOREN PËR TAKSA KOMUNALE
PËR VITIN 2024**

Procesverbali nga debati publik mbi Rregulloren për taksa komunale për vitin 2024, mbajtur me datë 15.09.2023 me fillim pune në ora 15:00 në zyrën e Sallën e Takimeve në katin e parë të objektit të komunës. Të pranishëm në debat ishin 15 pjesëmarrës/e, prej tyre 4 gra dhe 11 burra.

Takimin e kryesoi nënkryetari i komunës, Sevdi Dernjani, i cili përshëndeti të pranishmit dhe tregoi rëndësinë e kësaj Rregulloreje dhe ndikimin e saj në buxhetin komunal, duke e orientuar në kërkesat dhe projektet më të nevojshme të qytetit. Ndërkaq prezentimin e draft Rregullores për taksa komunale për vitin 2024 e bëri drejtorja e DZHE-s, Majlinda Kaloshi.

- **Prezentimi i draft Rregullores për taksa komunale për vitin 2024**

Majlinda Kaloshi: Çdo vit, Komuna bën parashikiet për taksa komunale e cila bazohet në Ligjin për Financa të Pushtetit Lokal, ku ne propozojmë që me vazhdu siç ka qenë, e cila njëherë ka kalu në Kuvend, dhe sipas procedurave të rregullta administrative, ky është dëgjimi i hapur publik, por jo zyrtarisht ne kemi marrë edhe propozimet e këshilltarëve komunal e poashtu edhe propozimet në këtë dëgjim do të evidentohen. Po filloj me propozimet e taksave tek Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ku kemi disa taksa të reja, të cilat kanë ardh si rrjedhim i bizneseve që janë regjistru gjatë vitit 2023, ka të bëjë me “Laboratorin”, “Subjektet afariste që merren me prodhimin e produkteve nga betoni për qëllime ndërtimi”, “Aktivitete të tjera të specializuara ndërtimi (dhënia me qira e kranave dhe pajisjeve tjera ndërtimore që u jepet operatorëve ekonomik)”, “Aktivitetet e tjera profesionale, shkencore dhe teknike (përfshirë aktivitete e patundshmërisë, auditimin, konsultimet në agronomi, mjedis)”, “Subjektet që merren me prodhimin e konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre”, çmimet për secilën janë në anën e djathtë. Më pas kemi taksat nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, të gjitha janë të bazume sipas Udhëzimit Administrativ dhe pëlqimeve që Ministria përkatëse i ka dhënë: “Taksa administrative për leje ndërtimore për kategorinë e I-rë dhe të II-të” janë ato që kanë pësuar ndryshime, dihet që Komuna është përgjegjëse për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve për leje ndërtimore, ndërsa për shkak të rrezikshmërisë lejet ndërtimore për kategorinë e III-të i jep Ministria përkatëse. Vlera e taksës për kategorinë e I-rë është 1.50 € për m², kurse për kategorinë e II-të është 2.50 € për m². Ndërsa “Taksa administrative për leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të” është 50 cent për m², poashtu vlen me cek se sipas pëlqimit që drejtoria përkatëse e ka marrë nga Ministria, “Taksa për densitet” do të hiqet plotësisht. Tek Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë do ta kemi një riemërtim të taksës, “Shfrytëzimi i hapësirave publike për vendosjen e objekteve argëtuese (parqeve argëtuese – Luna Park), kiosqeve të përkohshme, tendave për panaire. Taksa mujore për m².”, ku drejtoria ka kërku që nga kjo taksë të lirohen OJQ-të vendore. Te Drejtoria për Arsim kemi propozu një ngritje të “Taksë mujore për një fëmijë në çerdhe” ku nga 30€ është propozu që të bëhet 40 €, ndërsa “Taskë për dy fëmijë” nga 50 € është propozuar ngritje në 60 €. Këto janë propozimet e reja të taksave, kurse taksat tjera do të mbeten të njëjta siç ishin në vitin 2023. Këto janë propozimet tona, jemi të hapur edhe për propozimet tuaja.

- **Diskutimi**

Durim Dernjani: Tek propozimi i DSHPE-së që lirohen OJQ-të, po për organizatat tjera, shembull naj Ministri, ose Qeveria Japoneze ose dikush tjetër, që do me e bo një aktivitet, me vendos naj tendë ose diçka e tillë?

Majlinda Kaloshi: Kiosqet që kanë qëllim promovimi janë të liruar nga taksa.

Amir Berisha: Pse është propozu rritje për çerdhe?

Hisni Luri: Arsyeja e ngritjes së taksës për në çerdhe është në mënyrë që të ofrohen kushte sa më të mira për fëmijët. Nga prindërit kemi pas kërkesa të shumta në lidhje me komoditetin që ofrohet në çerdhe, mirpo duke pas parasysh numrin e fëmijëve në çerdhe dhe buxhetin në dispozicion, nuk ishte mundësia me u plotësu kërkesat e prindërve.

Sevdi Dernjani: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës sipas agjendës.

Mbledhja përfundoi në ora 15:14.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi














15.09.2023

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm

Debat Publik për Rregulloren e Taksave Komunale 2024 Hami i Elezit

Lista e pjesëmarrësve

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nr. tel	Emaili	Nëshkrimi
1	BUTAR BUSHI	[Redacted]	BUTAR-BUSHI	
2	Vlora Roguari	[Redacted]	Vlora.Roguari@qyteti.gov	
3	Kimok Shala	[Redacted]	kimokshala@qyteti.gov	
4	Madina Shala	[Redacted]	madina.shala@15-gov.net	
5	Amir Qasani	[Redacted]	amirqasani@qyteti.gov	
6	RAHMAN BUSHI	[Redacted]	rahmanbushi@qyteti.gov	
7	Ali Qasani	[Redacted]	ali.qasani@15-gov.net	
8	AMIN BENISHA	[Redacted]	AMIN_BENISHA@qyteti.gov	
9	BURTHAKI VIZA	[Redacted]	BURTHAKI.VIZA@PKS...	
10	DURJIN DERNTJANI	[Redacted]	durjin.derntjanid@qyteti.gov	
11	LIRIDONA BALLAZHI	[Redacted]	Liridona.ballazhi@rks-qyteti.gov.net	



222

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nr. tel	Emaili	Nënshkrimi
12	Arshi Daku	[Redacted]	arshi.daku@arko.com	[Signature]
13	Arsim Dervishi	[Redacted]	arsim.dervishi@arko.com	[Signature]
14	Arbion Bushi	[Redacted]	arbion.bushi@arko.com	[Signature]
15	Fari Shkërraj	[Redacted]		[Signature]
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				